

# UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT **A1**

## PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE PËR PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2010

### I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

1. **Formulari A1**; plotësohet për t'u regjistruar në Maturën Shtetërore 2010, **VETËM** nga maturantët e vitit shkollor 2009-2010.
2. **Formulari A1**, të plotësohet me shkronja të mëdha (kapitale).
3. **Formulari A1**, do të konsiderohet i vlefshëm **VETËM** nëse është plotësuar në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme. Në rast të kundërt ai do të konsiderohet i pavlefshëm dhe maturanti humbet të drejtën e regjistrimit.
4. Pasi të jetë plotësuar **Formulari A1**, të dorëzohet pranë **Komisionit Shkollor të Maturës Shtetërore (KSHMSH)**, ku maturanti vazhdon shkollën.
5. Plotësimi dhe dorëzimi i **Formularit A1**, fillon me datë **20 shkurt 2010** dhe përfundon me datë **10 mars 2010**.
6. Në rast se maturanti, ka bërë gabime në plotësimin e formularit, ai mund të plotësojë një formular tjetër **A1**, i cili zëvendëson të parin. Zëvendësimi i formularëve mund të pranohet nga **Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore (KSHMSH)**, vetëm brenda afatit të dorëzimit të tij (**10 mars 2010**). Pas këtij afati maturanti **NUK** ka të drejtë të bëjë ndryshime të tjera.
7. **Formularët A1**, pas plotësimit, kontrollohen me kujdes për saktësinë dhe më pas firmosen nga maturanti, mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës.
8. **Çdo formular duhet të vuloset me vulën e shkollës**

### II. UDHËZIME TË DETAJUARA PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT

Në hapësirat e lëna bosh tek Formulari **A1**, plotësoni:

1. Shkruani emrin e DAR ose ZA, ku ndodhet shkolla, pranë së cilës ju do të jepni provimin;
2. Shkruani emrin e qytetit ose fshatit, në të cilin ndodhet shkolla juaj;
3. Shkruani emrin e shkollës ku ju po studioni;
4. Bazuar në tabelën Nr.1 (Indekset e profileve/degëve), gjeni indeksin e degës dhe shënoni numrin që përfaqëson dega që ju po ndiqni, p.sh. Gjimnazi Drejtimi Shoqëror, në tabelë ka indeksin 2, në formular ju do shënoni numrin **2**. (*Plotësohet në bashkëpunim me mësuesin kujdestar*).
5.  Shënoni emrin tuaj       Shënoni emrin e babait       Shënoni mbiemrin tuaj  
**Kujdes!** - të shkruhen me germa kapitale dhe në përputhje me dokumentin e identifikimit.  
- të bëhet kujdes me shkronjat (**Ë**) dhe (**Ç**).
6. Shënoni datëlindjen tuaj, duke plotësuar me dy shifra ditën dhe muajin, (p.sh. 05/12/1989).

7. Vendorsni një shenjë në formë kryqi në kutinë që i përket gjinisë suaj. P.sh. nëse i përkisni gjinisë femërore shënoni një kryq [X] në kutinë përbri fjalës “Femër”;
8. Nxënësit që duan të vazhdojnë studimet në Itali shënojnë një kryq [X] në kutinë përbri PO.
9. Qarkoni IV ose V dhe shkronjat përkatëse A, B, C, D, E, F, G, H, I, K, L, M, N, O, P, Q, R, S. (P.sh. nëse jeni në klasën IV B, qarkohet IV dhe shkronja B dhe nëse jeni në klasën V D, qarkohet V dhe shkronja D). Në rastin kur shkolla ka përdorur numra për emërtimin e klasave, mësuesi kujdestar të konvertojë, numrin në shkronjë, sipas radhës së përcaktuar më sipër.
10. Bazuar në listën e lëndëve me zgjedhje të poshtëshënuar qarkoni 2 lëndët me zgjedhje që do të jepni provim dhe numrat që u korrespondojnë atyre.

P.sh. **6 NJOHURI PËR SHOQËRINË**

dhe **8.a ANGLISHT**

*Në lëndët që do të qarkohen, vëtëm njëra mund të jetë gjuhë e huaj. P.sh., nuk mund të qarkoni; Anglisht dhe Frengjisht, Anglisht dhe Italisht, etj.*

### **Shënim:**

- Nxënësi, firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Mësuesi, shkruan emrin dhe mbiemrin (me shkronja kapitale) dhe firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Drejtori, shkruan emrin dhe mbiemrin (me shkronja kapitale) firmos dhe vulos me vulën e shkollës, në hapësirën e përcaktuar për të.